



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0223

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Vedat Poterqoi - Kryetar, Isa Hasani dhe Vjosa Gradinaj Mexhuani - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) " VIBTIS " DEGA NË KOSOVË, kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të KOMUNES SE PRISHTINES në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1, me 30/05/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE " VIBTIS " DEGA NË KOSOVË me nr. 2024/0223, e datës 15/03/2024, kurse vendimi i AK KOMUNES SE PRISHTINES lidhur me aktivitetin e prokurimit Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.
2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik " VIBTIS " DEGA NË KOSOVË.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 13.07.2023, Komuna e Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit", me nr. të prokurimit: "616-23- 7016-1-1-1".Ndërsa me datën 26.02.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës furnizim dhe me vlerë të parashikuar të kontratës për 1,500,000.00 €

Me 01.03.2024, OE “Vibtis” dega në Kosovë ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Me 06.03.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 15.03.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE “Vibtis” dega në Kosovë me nr. 233/2024 për lidhur me aktivitetin “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit”, me nr. të prokurimit: “616-23- 7016-1-1-1”.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Vibtis” dega në Kosovë janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I) ankuesi pretendon se : 1. Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës (tutje referuar si: "Autoriteti Kontraktues"), ka publikuar Njoftimin për Kontratë me datë 14.07.2023, përmes të cilit ka kërkuar dorëzimin e ofertave për pajisje për pastrimin e kryeqytetit me titull “Furnizimi pajisje për pastrimin e kryeqytetit” dhe me numër të prokurimit 616-23-7016-1-1-1. 2. VIBTIS Dega në Kosovë (tutje referuar si: “Ankuesi”), brenda afatit të përcaktuar në dosjen e tenderit ka dorëzuar ofertë, duke i plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe Njoftimin për Kontratë. 3. Me datën 06.09.2023 në orën 14:00 është bërë hapja e ofertave dhe leximi çmimeve nga ana e Autoritetit Kontraktues. Ky raport është publikuar me datë 07.09.2023 i nënshkruar nga Zyrtari i Prokurimit. Nga raporti i hapjes dhe leximit çmimeve kemi kuptuar se në këtë aktivitet të prokurimit janë dorëzuar gjithsej 4 (ne fjalë: kater) oferta nga operator të ndryshëm ekonomik. 4. Pas trajtimit të raundit të ankesave dhe kthimit të lëndës në rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues me datën 26.02.2024 ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin ka njoftuar se synon anulimin e aktivitetit të prokurimit, kinse për shkak se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme. 5. Tek arsyet e eliminimit të Ankuesit, Autoriteti Kontraktues ka dhënë këtë arsyetim: “Komisioni vlerëson.52 OE Si dëshmi për përmbushjen e kësaj kërkesë ka ofruar një dokument i cili nuk mund të konsiderohet Katalog. Gjithashtu, dokumenti në fjalë nuk është i nënshkruar dhe i vulosur sipas kërkesës së DT, është i vitit 2019 si dhe është dokument i declikuar për Irak. Andaj komisioni vlerëson se është e papërgjegjshme”. 6. Në këtë mënyrë, Autoriteti Kontraktues nuk ka marrë në konsideratë faktin se dokumenti kishte QR Code dhe përmes të njëjtit mund të verifikoheshin të gjitha të dhënat tek lëshuesi i katalogut dhe ne si operator nuk mund të ndërhyjmë në modifikimin e tij. Duke pas

parasysh praktikat e kaluara të komunës me tentim për modifikim të dhënave të katalogjeve, Ankuesi konsideron se QR Code në këtë rast ka ofruar siguri për Autoritetin Kontraktues, më shumë sesa nënshkrimi apo vula tradicionale. 7. Brenda afatit ligjor Ankuesi ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim me të cilën ka paraqitur argumentet e veta, pse oferta është e përgjegjshme dhe se Vendimi për Anulim është në kundërshtim me Nenin 62 të Ligjit të Prokurimit Publik. Me datën 06.03.2024 Ankuesi ka pranuar Vendimin nga ana e Autoritetit Kontraktues me anë të së cilit është refuzuar si e pabazuar Kërkesa për Rishqyrtim dhe është vërtetuar Njoftimi mbi Vendimin e AK-së. II. Baza Ligjore Për Aprovimin E Ankesës 8. Autoriteti kontraktues në Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues ka konstatuar se dokumenti i ofruar për katalog nuk i plotëson kushtet për tu pranuar si i tillë. Arsye tjetër e përmendur në eliminim është fakti se katalogu është i panënshkruar dhe i pavulusur dhe katalogu është i vitit 2019 dhe i dedikuar për Irak. 9. Ne respektim të pikës 13 të DT, kemi paraqitur, katalogun e shasise dhe katalogun e super strukturës –mbi ndërtimit. Katalogu i shasise është venë në dispozicion nga CEYHAN OFOMOTIV, i cili është distributor i autorizuar i Renault Trucks. Katalogu i super strukturës është vendosur në dispozicion nga prodhuesi KARBA. Te dyja këto katalogje janë të paraqitura sipas kërkesave në DT. Katalogu të mbi strukturës i datës 25.08.2023 me Nr.0497R1, i përket mbi strukturës 16+1.5 m³ dhe katalogu i mbi strukturës i datës 25.08.2023 me Nr.0498R1, i përket mbi strukturës 8+1m³. 10. Dokumenti përmban të dhëna të detajuara për produktin të cilin në kemi ofertuar dhe është një katalog i mirëfilltë. Katalogu përbëhet nga fiete të homologuara, të personalizuar për kompaninë prodhuese KARBA. Në faqet e para të katalogjeve nr. Nr.0497R1 dhe Nr.0498R1 të tij ka të shënuar të dhënat si: Personin e kontaktit: Emiljon Xbemali, Drejtuar Klientit VIBTIS — Adresa Shqipëri, Njëkohësisht janë të shënuara dhe të dhënat e personit i cili përgatitur këtë dokument, me të dhënat: website, e-mail, numër kontrakti, adresën e kompanisë prodhuese KARBA. Në pjesën "HEADER" të çdo flete të katalogut ndodhet shënimi "Konfidencial" si dhe përmban KODIN UNIK QR. Ky dokument përmban të gjitha elementet e sigurisë që provojnë autenticitetin e tij. Katalogu e prezanton në detaje produktin e ofruar (superstrukturën) dhe i përmban të gjitha informacionet që përfshijnë specifikimet teknike, vizatimet, fotografitë me shpjegime përkatëse. Këtij katalogu i bashkëngjiten, në respektim të pikës 2 dhe 4, tek kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1&9.1 të DT , autorizimi i prodhuesit si dhe në respektim të pikës 5, Vërtetimi i firmosur dhe vulosur nga prodhuesi i superstrukturës KARBA bashkëngjitur specifikimet teknike. Pretendimi i AK, që dokumenti është i vitit 2019 është i gabuar. Nga shqyrtimi i katalogëve nuk rezulton që të jetë shënuar në asnjë vend viti 2019. Në lidhje me gabimet drejtshkrimore/materjale në shkrim " Irak", në fq.1 të katalogut i datës 25.08.2023 me Nr.0497R1, i përket mbi strukturës 16+1.5 in³ , nuk përbën shkak për përjashtim. Nuk ka shkelje të dokumenteve të tenderit, dhe për komisionin vlerësues ka qenë informatë jo relevante apo si një devijim i vogël që nuk do të duhej të ndikonte në vlerësim. Njëkohësisht në fq.17 të katalogut datës 25.08.2023 me Nr.0498R1, i përket mbi strukturës 8+1m³, përmendet që është për projektin Kosovë, e ku shprehimisht thuhet: "Thank you for your interest in our Garbage Compactor mounted on Renault D 10 LOW P4X2. Below you can find the full quotation related to your enquiry for your Kosova project. If you require any further assistance please do not hesitate to contact me or any of my colleagues at KARBA." Me këtë sqarohet se katalogu nga prodhuesi është i dedikuar për Kosovë dhe projektin përkatës, andaj çdo devijim është devijim njerëzor të cilat OSHP edhe në rastet paraprake i ka cilësuar si gabime të papërfillshme. Për të dëshmuar këtë ju lutem shiheni vendimin PSH. Nr. 902/19 të OSHP-së. 11. Katalogët teknikë, fotografitë, apo përshkrimet, i shërbejnë autoritetit kontraktues që të vërtetojë, se produktet e ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, plotësojnë kërkesat minimale të vendosura në dokumentet e tenderit. Pra, e rëndësishme është, që autoriteti kontraktues të ketë mundësi të

informohet me anë të një dokumenti të lëshuar nga prodhuesi mbi specifikimet teknike të produktit të prodhuar nga ky i fundit, pavarësisht se ky dokument mund të jetë katalog, deklaratë, përshkrim apo skedë teknike. OSHP-së i sjellim në vëmendje, se katalogët, skedat teknike etj. përpilohen nga prodhuesit në mënyrë standarde dhe deklarative, dhe përmbajnë ato informacione që prodhuesi i gjykon të nevojshme. Ne si operator ekonomik gjykojmë, se për sa kohë që përmbajtja e katalogut, nuk është në diskrecion të operatorit ekonomik pjesëmarrës, por është në diskrecion total të prodhuesit të produktit, atëherë ne si ofertues, që nuk jemi prodhues, nuk mund të penalizohemi për përmbajtjen e një dokumenti që nuk hartohet nga ne të fundit. Akoma më tej, gjykojmë, se krahas zhvillimit të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktues është përgjegjës edhe për monitorimin e kontratës gjatë zbatimit të saj. Gjatë fazës të lëvrimit/liferimit të mallit objekt-prokurimi, Autoriteti Kontraktues ka mundësinë që të verifikojë, nëse produkti i ofruar është në përputhje me specifikimet teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, si dhe me ofertën e premtuar nga operatori ekonomik në fazën e zhvillimit të tenderit.¹² Me që autoriteti kontraktues nuk ka pasur kërkesë specifike për informal dhe përmbajtje të katalogut, ka pasur mundësi që për secilën informate shtesë të kërkojë informacione për sigurimin e tenderit siç parashihet me dispozitat e Ligjit të Prokurimit Publik për sigurimin e tenderëve. Në këtë mënyrë do të ofroj çdo informate e nevojshme komisionit vlerësues një operator nuk mund të eliminohet për kërkesë të cilat nuk janë pjesë e kërkesave të dosjes së tenderit. 13. Duke mos kërkuar sqarime nga ne si ofertues apo prodhuesi, Autoriteti Kontraktues nuk ka luajtur e saj pozitiv në sigurim të trajtimit të barabartë të operatoreve dite arritjes së vlerës për paranë. 14. Në nenin 53, paragrafi 3 thuhet: "Vetëm kriteret e matshme dhe të cilat paraprakisht janë përcaktuar në dosjen e tenderit mund të shfrytëzohen për vlerësim. Autoriteti kontraktues mund të përdorë kritere që janë relevante në mënyrë direkte me lëndën e kontratës." Në këtë rast meqë nuk ka pasur kërkesë specifike për përmbajtjen e tenderit, autoriteti kontraktues ka bere shkelje të Nenit 53 në momentin e eliminimit të ofertës së Ankuesit si të papërgjegjshme, për kërkesa që nuk ekzistoni? në dosjen e tenderit. 15. Sipas praktikës së OSHP-së Autoriteti kontraktues e vlerëson një oferte të vlefshme është nëse ajo përmban devijime të vogla, të argumentuara, të cilat nuk ndryshojnë thellësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si edhe gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj. Po ashtu në lidhje me devijimet e vogla ju lutem referojuni standardit të krijuar në Vendimin OSHP: 2023/1029, në rastin tonë janë shume me të papërfillshme sesa ato të rastit të cituar. Vlerësojmë dite këmbëngulim që Autoriteti Kontraktues ka pasur mundësinë që të kërkojë sqarime shtese, për të gjitha pretendimet e ngritura në vendimin për shpalljen si të papërgjegjshme të ofertës tone, por në kundërshtim me ligjin e LPP-së, ka shmangur me vetëdije marrjen e këtyre informacioneve. 16. Përkundër të gjitha arsyeve të theksuara me lartë, vlen të bëjmë një përmbledhje të shkurtër, të gjithë ecurisë së kësaj procedure. Ne si ofertues në këtë procedure, kemi respektuar dokumentet e tenderit. Duam të theksojmë se kjo është hera e dyte që i drejtohem OSHP-së me ankimit, kundër vendimit të marre në mënyrë të padrejte dhe tendencioze ndaj nesh. Në ankimin e parë kemi parashtruar që AK, në mënyrë të padrejte e kishte përcaktuar ofertën tone si të papërgjegjshme. Kjo për faktin që kinse nuk plotësonim kërkesën mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nr.1 neni 9.1 & 9.2 kapaciteti teknik dhe profesional pika 1, sipas kontratave të dorëzuara me referenca nuk arrin vlerën e kërkuar 2,000,000.00 Euro. Edhe pasi kemi bere kërkesën për rivlerësim, ku e kemi arsyetuar në AK ka marre vendimit në zbatim dhe interpretim të gabuar të ligjit dhe dokumenteve pjese të ofertës, përsëri ka vazhduar se "kokëfortësi" të arsyetoj gabimin e bere, kundër ofertës tone. 17. Ky arsyetim mbështet në vendimin e datës 26.02.2021 të Komisionit të Vlerësimit, pasi pretendimi për "kantatat e dorëzuar me referenca nuk arrin vlerën e kërkuar 2,000,000.00Euro", gjatë fazës së rivlerësimit, pas vendimit të OSHP-së nuk u ngrit me nga AK, ky pretendim i paqëndrueshëm. Konstatimet e AK në vendimin e

datës 26.02.2024, nuk janë përmendur dite as rritur ne asnjë nga vlerësimet e bëra me pare. Dokumentet pjese e ofertës Vibtis Dega Ne Kosove, janë ne posedim të Autoritetin ne momentin e hapjes së procedurës. Autoritetit kontraktues i janë dashur pse muaj "qe kuptojë katalogun nuk është ne formën e duhur, dedikohet projekti Irak dhe jo Kosove si dhe është dokumenti vitit 2019". A.K duhet të kishte shpallur ofertën tone fituese për dhënie te kontratës , nëse do te kishin vlerësuar drejt ofertën tone. 18, Autoriteti Kontraktues caktoj shoqërinë Haxhijaja, fituese edhe pse kjo e fundit nuk plotësonte kriterin e punës se ngjashme pasi qe i mungonin referencat e natyrës së kontratës sipas kodeve përkatëse të prokurimit. Tek vendimmarrja e datës 26,02.2024, AK, pretendon që ky i fundit ka modifikuar katalogjet. Pas kërkesës për rivlerësim AK, caktoj si oferte fituese, shoqërinë D&T, ne kundërshtim me dokumentet e tenderit, pasi te njëjtit kishin paraqitur dokumente te modifikuara/ndërhyrje, e cila u provua nga eksperti shqyrtues ne OSHP . Ndërkohe oferta jonë është totalisht serioze, plotësojmë të gjitha kriteret e përcaktuar në dosjen e tenderit dhe nuk shpallemi fitues.”

Duke u referuar pretendimeve si më sipër OE “Vibtis” dega në Kosovë konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 6, 7, 41, 59 LPP-së si dhe neni 68 i Ligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike. Andaj, duke marre për bazë të gjitha argumentet dhe provat e dorëzuara me këtë Ankesë me respekt i kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit, që pas shqyrtimit të Ankesës të nxjerr këtë: Vendim I. Aprovohet ne tërësi si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Vitbis” Dega ne Kosove, e datës 15,03.2024, kundër mbi Vendimit e Autoritetit Kontraktues Komuna e Prishtinës. 2. Anulohet Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 26.02.2023 dhe lënda kthehet në Rivlerësim. 3. Lejohet kthimin i depozitës së paguar me rastin e parashtrimit të ankesës për ankuesit të cilët konform nenit 31, pika 6 të Rregullores së punës se OSHP, kane të drejte të paraqesin kërkesë për kthimin e mjeteve, ne afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, ne të kundërtën mjetet konfiskohen dhe kalojnë ne Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Përgjigje ne kërkesën për Rishqyrtim : “Lidhur me pretendimet e parashtruesit fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar dhe raportin e komisionit vlerësues, arsyet për eliminimin e parashtruesit janë si në vijim: OL VIB1IS DEGA NË KOSOVË . sipas kërkesës ne D1 nr. 13. për katalogun e kërkuar si ne vijim: Kërkesa : OE duhet të dorëzoj: a. Katalogun e shashisë dhe b. Katalogun e superstrukturës-mbi ndërtimit. Dëshmi: (Katalogu i nënshkruar dhe i vulosur). Komisioni vlerëson se OE si dëshmi për përmbushjen e kësaj kërkesë ka ofruar një dokument i cili nuk mund të konsiderohet Katalog. Gjithashtu. dokumenti në fjalë nuk është i nënshkruar dhe i vulosur sipas kërkesës të DT, është i vitit 2019 si dhe është dokument i dedikuar për Irak. Andaj komisioni vlerëson se është e papërgjegjshme. Tenderi i juaj Kërkesa e juaj për pjesëmarrje është administrativisht e papërgjegjshme. Nga administrimi i dokumenteve me të cilat ka ofertuar parashtruesi, është konfirmuar konstatimi i komisionit vlerësues sipas të cilës parashtruesi nuk e ka dorëzuar katalogun e kërkuar sipas dosjes së tenderit. Parashtruesi në vend të katalogut ka dorëzuar një dokument tjetër i cili nuk mund të cilësohet si katalog dhe i cili as si i tillë nuk është as i nënshkruar dhe as i vulosur sikurse është kërkuar me dosjen e tenderit. Për më tepër ky dokument është i vitit 2019 (mbi 4 vite para publikimit të njoftimit për kontratë) dhe i cili dokument si i tillë është i dedikuar për shtetin e Irakut dhe jo për shtetin e Kosovës aq më pak për Autoritetin Kontraktues apo aktivitetin e prokurimit për të cilin ka tenderuar. Pretendimet e parashtruesit janë se dokumenti nuk ka pasur nevojë të jetë i nënshkruar dhe vulosur sepse posedon QR Code mirëpo ky pretendim është i

pabazuar pasi që në dosjen e tenderit thuhet specifikisht se katalogu duhet të jetë i nënshkruar dhe i vulosur. Njëkohësisht parashtruesi pretendon se përmes QR Code mund të hulumtohet një link në internet ku mund të ketë informacione shtesë për këtë dokument. Mirëpo edhe ky pretendim është i pabazuar sepse kërkesë e dosjes së tenderit ka qenë që të dorëzohet katalogu si i tillë dhe jo linku apo QR Code. Po ashtu parashtruesi pretendon se fakti që dokumenti është i vitit 2019 dhe është i destinuar për shtetin e Irakut është detaj i parëndësishëm. Mirëpo edhe ky pretendim është i pabazuar pasi që destimi i dokumenteve me të cilat ofertohet për aktivitetin e prokurimit është elementi më thelbësor që mund të ketë një tender i një operatori ekonomik. Pra autoriteti kontraktues nuk mund të trajtoj si të pranueshëm një dokument që është i destinuar për një shtet tjetër para 4-5 viteve. Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimin e tij. Njëkohësisht nga provat materiale të administruara është gjetur se pretendimi i parashtruesit është tërësisht i pabazuar. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.”

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 22.03.2024 ka autorizuar ekspertin për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 223/2024, ndërsa me datë 29.03.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit me nr. 2024/223 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues Nuk Pajtohet lidhur me rekomandimin e ekspertit, Ndërsa OE Pajtohet me rekomandimin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtruesit, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtruesit dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE “Vibtis” dega në Kosovë eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/223 ka vlerësuar si në vijim:

Sqarim hyrës: “Eksperti shqyrtues sqaron se pretendimet ankimore kanë të bëjnë kundër arsyetimit të anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizim me pajisje për pastrimin e kryeqytetit”, me nr. të prokurimit: 616-23-7016-1-1-1. Përkatësisht, arsyetimin e eliminimit ku AK përmes letrës standarde të datës: 26/02/2024, ndaj ankuesit ka potencuar se: “Komisioni vlerëson se OE si dëshmi për përmbylljen e kërkesave të kapacitetit teknik dhe profesional, ka

prezantuar si dëshmi Dokument i cili nuk mund të konsiderohet si katalog, gjithashtu dokumenti në fjale nuk është i nënshkruar dhe vulosur sipas kërkesës së DT-së, është i vitit 2019 si dhe është dokument i dedikuar për IRAK.”

Konstatimi i parë (I):“Sa i përket pretendimeve ankimore, lidhur me arsyetimin e eliminimit, eksperti shqyrtues sqaron se Autoriteti Kontraktues – Komuna Prishtine të kërkesat e kapacitetit teknik dhe profesional, konkretisht në pikën 13, ka kërkuar nga OE katalogun e shasisë dhe katalogun e superstrukturës – mbindërtimit. Përkundër faktit se si dëshmi dokumentare, AK ka kërkuar katalog të nënshkruar dhe vulosur, eksperti shqyrtues vlerëson se mos nënshkrimi i katalogut sa i përket kësaj procedure të prokurimit nuk e bën ofertën të papërgjegjshme, pasi që OE ankues në oferte ka prezantuar Autorizim të po të njëjtit prodhues i nënshkruar dhe një gjë e tillë nuk kontestohet, rrjedhimisht edhe katalogu përmban të dhënat e të njëjtit prodhues. Që nga plotësimi dhe ndryshimi i Ligjit për Prokurim Publik në vitin 2016, obligim ligjor është si nga AK-te po ashtu edhe nga OE-te që iniciimi dhe ofertimi të realizohet përmes platformës E Prokurimi dhe një gjë e tillë është realizuar edhe sa i përket këtij aktiviteti të prokurimit. Për më tepër, edhe praktika e vendosur në OSHP është e tillë, ku vetë ankuesi në ankese ka prezantuar vendim paraprak të nxjerre nga OSHP për çështje të ngjashme, konkretisht dispozitat ligjore dhe nënligjore e obligojnë Autoritetin Kontraktues që për çështje të tilla përgjatë procesit të vlerësimit apo rivlerësimit të ofertave, të kërkojnë sqarim – plotësim të dokumentacionit i cili duket apo mund të jete jo i plote apo jo i sakte, prandaj eksperti shqyrtues konsideron se AK ka qene dashur t’i aplikojë dispozitat e nenit 59 dhe 72 të LPP-së për dokumentin, përkatësisht katalogun nëse për të njëjtin kanë pasur dilema. Prandaj, pretendimin ankimor sa i përket arsyetimit të eliminimit, eksperti shqyrtues e trajton si të bazuar. Për më tepër neni 10 i Udhëzuesit Nr. 001/2023, për Prokurim Publik, shembujt varësisht nga rasti i paraqitur tek AK e obligon AK-ne që të veproje në përputhje me dispozitat e sipër përshkruara. Përkatësisht, kjo dispozite ligjore përcakton se në rastin kur katalogu nuk është prezantuar fare në oferte, AK është i obliguar që të kërkojë sqarim shtese. Në këtë rast, AK konteston vulën dhe nënshkrimin por nuk e konteston specifikacionin teknik sa i përket pajisjes – produktit për të cilin pretendohet të kontraktohet. “

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Vibtis” dega në Kosovë Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e eksperteve mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Vibtis” dega në Kosovë janë të bazuara.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit”, me nr. të prokurimit: “616-23- 7016-1-1-1”. Paneli shqyrtues vlerëson se ekspertit shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Vibtis” dega në Kosovë dhe se, Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues “Vibtis” dega në Kosovë janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik të aprovet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Furnizimi me pajisje për pastrimin e kryeqytetit”, me nr. të prokurimit: “616-23- 7016-1-1-1”, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. AK të veproj në raport me dispozitat ligjore (LPP) dhe dispozitat nën ligjore të PP-së.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbëjnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim.

Panelit Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues
Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - " VIBTIS " DEGA NË KOSOVË**
- Arkivës së OSHP-së: